



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2023

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi dhe gjimnazi gjuhësor)

Varianti B

Shënim: Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, që kanë më shumë se një mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh, edhe me përgjigje të përafërta.

PJESA I

Çfarë më frymëzon!

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë
Pyetja 8	A	1 pikë
Pyetja 9	D	1 pikë
Pyetja 10	C	1 pikë

Pyetja 11 **3 pikë****Përgjigje:***Kundrinori:* Princin e vogël*Lloji:* I drejtë*Me se është shprehur:* Grup emëror**3 pikë** Nëse nxënësi gjen kundrinorin, llojin e tij dhe tregon me se është shprehur.**2 pikë** Nëse nxënësi gjen kundrinorin dhe llojin e tij, **OSE** kundrinorin dhe thotë me se është shprehur.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm kundrinorin.**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 12** **2 pikë****Përgjigje:***Forma e pashtjelluar foljore:* për të ndihmuar*Lloji:* paskajore**2 pikë** Nëse nxënësi gjen formën e pashtjelluar foljore dhe tregon llojin e saj.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm formën e pashtjelluar foljore.**0 pikë** Nëse nxënësi nuk përgjigjet fare ose jep përgjigje të gabuar.**Pyetja 13** **4 pikë****Model përgjigjeje:***Karakteristikat gjuhësore:*

- Përdorimi i vetës së parë. (Në fjalimin para shkollës me rastin e diplomimit tim, ndër të tjera unë rrëfeva edhe për frymëzimin...).
- Përdorimi i foljeve në kohën e tashme dhe në kohën e shkuar (kryesisht në kohën e kryer të thjeshtë (zbuloj, rrëfeva etj.)
- Gjuha e përdorur është e ngjashme me ligjërimin bisedor, e thjeshtë, e qartë dhe e prekshme. (Në fjalimin tim para shkollës...).
- Përdorimi i dendur i foljeve që tregojnë veprime, ndjenja, ngjarje etj. (Kam mahnitur, të tregojmë, më mban të angazhuar, përjetoj, heq dorë etj.)
- Etj.

4 pikë Nëse nxënësi jep dy nga karakteristikat gjuhësore me shembujt përkatës.**3 pikë** Nëse nxënësi jep dy karakteristikat gjuhësore dhe vetëm një shembull.**2 pikë** Nëse nxënësi jep një karakteristikë me shembullin përkatës, ose nëse jep vetëm dy karakteristikat gjuhësore.**1 pikë** Nëse jep vetëm një karakteristikë.**0 pikë** Nëse nxënësi nuk përgjigjet fare ose jep përgjigje të gabuar**Shënim:** Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përgjigje të nxënësit, që nuk është si formulimet më lart, por që në një mënyrë tjetër, të çon në veçori gjuhësore të tekstit.

Pyetja 14 **1 pikë****Model përgjigjeje:**

Njeriu nuk i gjen gjithmonë përgjigjet në libra dhe filma. Jeta është shumë dimensionale, shpesh plot drama, prej të cilave ai duhet të mësojë. Përvoja jetësore është udhërrëfyese më i mirë. Nga përvojat e librave dhe filmave vetëm i shtojmë ngjyra realitetit tonë. Njeriu duhet të jetë i përgatitur për jetën, sepse sado dije të zotërojë, sërish përballet me situata që nuk i ka ndeshur kurrë dhe zgjidhjet në këtë rast janë krejtësisht individuale.

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon arsyen.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Do të pranohet nga vlerësuesi çdo përgjigje e përafërt me kuptimin e përgjigjes model.

Pyetja 15 **1 pikë****Përgjigje:**

Gjymtyrët homogjene: botën, njerëzit dhe problematikat

1 pikë Nëse nxënësi gjen gjymtyrët homogjene.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 **3 pikë****Model përgjigjeje:**

Burimet:

- I ati
- Librat
- Burimet digjitale
- Filmat
- Modelet si Sizifi
- Citimet motivuese
- Dashuria për jetën

Këto burime shërbejnë për ta motivuar rrëfimtarin, e bëjnë optimist, i shtojnë dashurinë për jetën etj.

3 pikë Nëse nxënësi gjen dy nga burimet dhe tregon përse i shërbejnë.

2 pikë Nëse nxënësi gjen një nga burimet më lart dhe tregon përse i shërben ose vetëm dy burimet pa shpjegimin.

1 pikë Nëse nxënësi gjen ose njërin burim ose thjesht tregon se ai frymëzohet përmes burimeve.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **2 pikë****Model përgjigjeje:**

Kjo është një fjali motivuese që flet për frymëzimin dhe optimizmin, kështu që analiza e saj shprehje do të bëhet në funksion të temës dhe mesazhit të pjesës.

2 pikë Nëse nxënësi analizon duke vënë në dukje të kuptuarit e ringritjes dhe të efektit që ajo ka në jetën e njeriut.

1 pikë Nëse nxënësi analizon pjesërisht thënien.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II

Honore de Balzak “Xha Gorioi”

Pyetja 18	A	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	B	1 pikë
Pyetja 21	D	1 pikë
Pyetja 22	C	1 pikë
Pyetja 23	A	1 pikë
Pyetja 24	C	1 pikë
Pyetja 25	A	1 pikë
Pyetja 26	B	1 pikë
Pyetja 27	A	1 pikë

Pyetja 28 4 pikë

Model përgjigjeje:

a) Ilustrime nga fragmenti që shprehin pasionin mbizotërues të Gorioit për të bijat:

- S'jam më baba.
- Të shkoja të vidhja.
- Mu dërrmua zemra.
- Unë varfanjaku.
- Ngordh si qen që je.
- Koka po më zien.
- Do të ha bukë thatë.
- Nuk do sëmuren se pastaj vajzat nuk do të shkojnë në ballo.
- Vetëm kështu mund të laj fajin që bëra duke siguruar të ardhura jetike.

b) Gjendja shpirtërore e Xha Gorioit është e rënduar, i dërrmuar, i çorientuar dhe pa asnjë shpresë, gati-gati i çmendur. Ai është i sëmurë në shtratin e vdekjes. Në pamundësi për të plotësuar çdo tekë të të bijave ai mendon se nuk meriton të jetë prind, madje nuk meriton as të jetojë.

4 pikë Nëse nxënësi ilustron me dy shembuj dhe analizon gjendjen e Gorioit.

3 pikë Nëse nxënësi jep një shembull dhe bën analizën e plotë **OSE** nëse jep dy shembuj dhe vetëm tregon si ndihet Gorio pa e analizuar gjendjen e tij.

- 2 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm dy shembujt, **OSE** një shembull dhe tregon si ndihet Gorio, **OSE** vetëm analizon saktë gjendjen e Gorioit pa dhënë asnjë shembull.
- 1 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm një shembull **OSE** vetëm tregon si ndihet Gorio, **OSE** analizon pjesërisht e Gorioit.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të përafërt me përgjigjet e skemës së vlerësimit.

Pyetja 29 **1 pikë**

Përgjigje:

Krahasim (si qen)

- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen figurën stilistike.
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30 **2 pikë**

Model përgjigje:

Këtu arrin kulmin pasioni mbizotërues i Gorioit për të bijat, i cili shkon deri në vetëfljirim. Në fjalinë e parë Gorioi është i gatshëm të sakrifikojë në maksimum dhe fjalia që lexuesi pret të vijë më pas është për një arsye madhore, siç është jeta e të bijave. Por në fakt fjalia pasuese është në kontrast me të parën, pasi arsyeja e gjithë kësaj sakrifice është qesharake, është për një tekë, nuk është fare e motivuar. Kontrasti tregon kufijtë deri ku mund të shkojnë ndjenjat njerëzore kur janë me tepri dhe pa arsye.

- 2 pikë** Nëse nxënësi shpjegon këtë kontrast përmes referimit të dy fjalive nga teksti.
- 1 pikë** Nëse nxënësi bën një shpjegim të pjesshëm.
- 0 pikë** Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.

Pyetja 31 **2 pikë**

Model përgjigjeje:

Kjo përgjigje jepet duke shkëputur fjalinë nga teksti si:

Faji që bëra duke siguruar për vete një të ardhur jetike, ose duke perifrastuar këtë ide.

Vetë autori përdor ironinë kur flet për këtë temë, pasi mendon që Xha Gorio nuk ka kurrfarë faji.

Përgjigjet mund të jenë pro ose kundër mendimit të autorit, por gjithmonë duke dhënë argument mbështetës. Për shembull: Unë mendoj si autori. Ai ka përdorur ironinë duke folur për "fajin" e Xha Gorioit. Vetë Gorio thjesht ka siguruar të ardhurat e veta jetike, duke u dhënë vajzave gjithçka tjetër, por pasioni i sëmurë me të cilin ai i do vajzat, e bën atë të vuajë edhe faje që nuk i ka.

- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen fajin dhe jep një argument mbështetës për përgjigjen.
- 1 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet vetëm për pyetjen e parë: Cili është faji?
- 0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Komisioni do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të nxënësit, që edhe në mënyrë të përafërt është brenda kontekstit të përgjigjes në skemë.

Pyetja 32 2 pikë

Model përgjigje:

Balzaku godet fort me figurën. Kjo figurë ironike, goditëse ka një efekt të fortë tek lexuesi. Krimi nuk duket, por vrasja ndodh. Indiferenca e të bijave është vrasëse për Gorioin, një vrasje elegante, siç e diktojnë sallonet mondane të kohës, pa zhurmë dhe pa skandal.

2 pikë Nëse nxënësi shpjegon figurën nga ana kuptimore si dhe efektin e saj.

1 pikë Nëse nxënësi bën një shpjegim të pjesshëm.

0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.

Shënim: Vlerësuesi i testit do të vlerësojë çdo përgjigje që komenton këtë shprehje të Balzakut, duke u mbështetur në shpjegimin që nxënësi bën nisur nga informacioni në fragment, por edhe në kontekstin e veprës në tërësi.

Pyetja 33 3 pikë

Model përgjigjeje:

a) Delfina del e ftohtë, egoiste, e pandjeshme, madje edhe ndaj faktit se i ati është në momentet e fundit të jetës së tij, ndërsa Rastinjaku del i zhgënjyer, i çuditur, i pafjalë teksa sheh sesa e pandjeshme është gruaja që ai dashuron dhe i pikëlluar për gjendjen e rëndë të xha Gorioit, të cilin ai e quan baba.

b) Nga i gjithë dialogu Rastinjaku **ndihet i trishtuar**, i pikëlluar.

3 pikë Nëse nxënësi zbulon karakteret e dy personazheve dhe shkruan si ndihet Rastinjaku.

2 pikë Nëse nxënësi zbulon vetëm dy karakteret, ose zbulon një karakter dhe ndjesinë e Rastinjakut.

1 pikë Nëse nxënësi gjen njërën prej tyre.

0 pikë Nëse nuk përgjigjet fare ose gjen përgjigje të gabuara.

Pyetja 34 2 pikë

Në këtë përgjigje duhet të dalë që ky pasion dhe problem që ka Xha Gorio haset rëndom në shoqëri dhe mesazhi që përcillet është universal dhe aktual.

Forca përgjithësuese:

Xha Gorio nuk është i vetëm në këtë dramë të tijën. Mesazhi është i fortë dhe përgjithësues: Gjendja e shoqërisë njerëzore është e rëndë sa kohë që boshti i saj, dashuria prind – fëmijë, është i cenuar dhe i rrezikuar. Bota që njeh Balzaku është vendi ku lulëzon vesi. Mospërfillja e vajzave ndaj babait nuk është thjesht ves i tyre, por ves i një shoqërie që po shkon drejt një degjenerimi moral.

Filozofia e kohës është:

- forca tjetërsuese e parasë.

- rreziku i shkatërrimit të familjes, i cili vë në pikëpyetje themelet e shoqërisë.

2 pikë Nëse i shpjegon të dyja forcën përgjithësuese universale dhe aktuale dhe realitetin si filozofi të kohës.

1 pikë Nëse shpjegon vetëm njërën ose edhe nëse i shpjegon pjesshëm të dyja .

0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.

PJESA III

Pyetja 35

8 pikë

Për pjesën *ese* do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

Shtjellimi i idesë

2 pikë

- Shkruan një ese, ku shtjellon dëshirën, durimin dhe vullnetin për të gjetur frymëzimin dhe për të arritur sukses në jetë. Njerëzit pozitivë, optimistë, që duan jetën nuk heqin dorë nga asgjë. Ata ecin vetëm përpara.
- Zbërthen arsyen e vërtetë të frymëzimit dhe shembujt që të çojnë te një frymëzim pozitiv.
- Sjell përvoja të ndryshme personale, të cilat mbështetin bindshëm argumentin, jep shembuj dhe krijon përfytyrime

Organizimi dhe struktura

2 pikë

- Përdor strukturë të qartë eseje: hyrje-zhvillim-mbyllje.
- Siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- Grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- Zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- Përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

Stili dhe origjinaliteti

2 pikë

- Përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- Përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- Përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- Përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

Saktësia gjuhësore

2 pikë

- Përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- Shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- Përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

Shënim: Në vlerësimin e esesë, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Nga ana tjetër, ky komision do të ketë parasysh, që për rubrikën stili (ku deri më sot janë treguar më të rezervuar) të mbahet në konsideratë që shkruesi i esesë është një nxënës dhe jo një shkrimtar.

Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të nxënësit.

